GJSK-KPA-A-004/2020

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

Drita Morina nga Prishtina, rr. "Maliq Pashë Gjinolli", nr.4.
Ankesa e ushtruar nga i autorizuari i saj, Avokat Skender Musa nga Prishtina rr."Garibaldi",

Kundër:

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, (AKKVP),

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër njoftimit për lirimin e pronës-banesës nën shenjën DS002241, të datës 28.10.2020, në zbatim të Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore,(tutje; KÇPB),nr. HPCC/D/226/2005/A&C, të datës, 22 Tetor 2005, pas shqyrtimit në seancën e mbajtur me datë 24 Dhjetor 2020, merr:

AKTVENDIM

Hedhet Poshtë si e pa lejueshme, Ankesa e D. M., e parashtruar nga përfaqësuesi sipas autorizimit avokat, S. M., kundër Njoftimit DS002241, të datës 28.10.2020, lidhur me zbatimin e Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, HPCC/D/226/2005, të datës 22 Tetor 2005.

<u>Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;</u>

1. Nga shkresat e lëndës të bashkangjitura nga pala ankuese dhe theksimeve në ankesë rezulton se; për pronën lëndore,(Banesën në Prishtinë, rr."…, në sipërfaqe prej 30.59m2), Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore, kishte nxjerrë Vendimin HPCC/D/226/2005/A&C, I dt.22.10.2005, me të cilin vendim janë vendosur kërkesat DS002241, e palës kërkuese H. S., dhe kërkesa DS001970 ,e palës përgjegjëse R. D.), sipas të cilit palës kërkuese H. S., i ishte njohur e drejta pronësore në banesën lëndore, ndërsa palës tjetër e drejta e kthimit-kompensimit të qmimit blerës të saj, (që të dyve nën kushte të caktuara ligjore si në pikat tjera të vendimit).

2. AKKVP, sipas Ligjit 05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. për veq mandatit kryesor të saj, ka trashëguar një pjesë të përgjegjësive dhe të mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të ish Drejtorisë për Çështje Banesore dhe

Pronësore, (kësaj të fundit kryesisht lidhur me implementimin e vendimeve të saj të plotëfuqishme), ashtu si parashihet në nenet 17-19, të këtij ligji.

3. AKKVP, në këtë qështje pas përfundimit të procedurave pregatitore rreth kritereve dhe procedurave të përllogaritjes së shumave dhe pagesave nga komisioni vlerësues, ka filluar procesin e zbatimit të vendimit të plotëfuqishëm të Komisionit për Kërkesa Banesore Pronësore HPCC/D/226/2005/A&C të dt. 22 tetor 2005. Me vendimin e vërtetuar të dt. 08.01.2020, H. S. i aprovohet pronësia dhe urdhëron që të regjistrohet në kadastër si pronar ligjor i banesës lëndore nga dita e pranimit të këtij urdhëri. Ndërsa qdo person që pa të drejt e ka uzurpuar apo gjendet në banesë duhet ta liroj në afat prej 30 ditë.

4. Agjencia për krahasim dhe verifikim të pronës palës ankuese D. M. ia dërgon njoftimit për lirimin e pronës-banesës nën shenjën DS002241, të datës 28.10.2020, në zbatim të Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, (tutje; KÇPB), nr. HPCC/D/226/2005/A&C, të datës, 22 Tetor 2005, me të cilin ajo njoftohet se duhet ta liroj banesën e cila gjendet në rr. …, me sipërfaqe prej 30.59,m2

5. E pa kënaqur me këtë njoftim pala ankuese ushtron ankesë në gjykatë Supreme, ku ndër të tjera thekson se; banesën lëndore e ka fituar për mes kontratës së faljes nga nëna e saj e cila e kishte në pronësi të ligjshme, të cilën e kishte blerë sipas kontatës së shitblerjes VR.5208/2002, në vitin 2002 nga R. D., se pala tjetër pretenduese H. S. nuk ka kurrfar të drejte në këtë banesë sepse ai e kishte vetëm të drejtën e shfrytëzimit, andaj vlerëson se procedura e zhvilluar nga AKKVP, është bërë në mënyrë të gabuar kundër L. D.ć, ndërsa pala ankuese nuk është njoftuar asnjëhere deri sa e ka pranuar njoftimin për lirimin e banesës, andaj kërkon që njoftimi i AKKVP të anulohet-pezullohet dhe qështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, ashtu që si palë në procedurë të ftohet pala ankuese si pronare e banesës, pasi që procedura është zhvilluar për një person tjetër që nuk ka qen pronar dhe posedues I saj . Në parashtresën e dt 05.11.2020, propozon të anulohen, edhe vendimi i Komisionit për Çështje Pronësore Banesore HPCC/D/226/2005/A&C, i dt.22.10.2005, mandej njoftimi, nr…., i dt. 14.07.2020, dhe Aktvendimi për caktimin e vërejtjes, nr. 011-…, i Agjencisë kadastrale.

Arsyetimi ligjor;
*-Juridiksioni***,**

6. Gjykata Supreme, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndëve sipas ankesës të ish Agjencisë Kosovare të Pronave, tani Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, pas shqyrtimit të ankesës gjen se, kjo gjykatë nuk ka juridiksion për të shqyrtuar dhe Vendosur lidhur me njoftimimin e atakuar me ankesë, sepse ky njoftim-urdhër dëbimi është implementues dhe i ndërlidhur me qështjen kryesore të vendosur sipas vendimit nr. HPCC/D/226/2005/A&C, të dt.22.10.2005, të cilin vendim po ashtu gjykata supreme nuk ka kompetencë ligjore për të vendosur lidhur me te.

7. Në kuptim të nenit 15.1 të Ligjit të AKKVP, kundër vendimit të Komisionit për verifikim dhe vendosje të pronës, dhe kundër vendimit të Komisionit për kërkesa pronësore palët brenda afatit prej 30 ditë, mund të paraqesin ankesë në Gjykatën Supreme për mes Sekretarisë së Agjencisë.

8. Sipas Ligjit në fuqi nr.05/-L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të pronës, nuk është e paparë që vendimet e Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore (DÇBP), apo aktet e tjera lidhur me këto vendime, që mund të jenë objekt i kontestimit qoft me padi apo me ankesë në Gjykatë Supeme, gjer sa sipas neneve 17-19, të këtij ligji AKKVP, ka kompetenca të ekzekutoj vendimet e plotëfuqishme të Komisionit për Kërkesa Pronësore, aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore,(Habitat HPCC), dhe të bëjë lëshimin dhe ekzekutimin e urdhërit për dëbim të qdo personi që është duke qëndruar në mënyrë të pa ligjshme në një pronë, të vendosur me vendim të plotëfuqishëm.

9. Nga faktet e cekura më lartë rezulton se kjo qështje banesore është vendosur me Vendimin e ankimuar të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, nr.HPCC/D/226/2005/A&C, të dt.22.10.2005.

10. Sipas nenit 2.7, të Rregullores së UNMIK, nr.1999/23, të datës 15 Nëntor 1999, Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar **dhe nuk janë subjekt i ri shqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.**

11. Vendimi i ankimuar, HPCC/D/226/2005/A&C, i dt. 22.10.2005, është i potëfuqishëm dhe i formës së prerë, në pajtim me nenin 2, paragraf 7, të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23. I njëjti nuk mund të ankimohet, në këtë fazë, as sipas Rregullores së UNMIK nr.2000/60, sepse dispozitat e këtyre dy rregulloreve të cekura si më lartë, si dhe aktet ligjore të më vonshme dhe tani në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi, nuk parashofin ndonjë mjet juridik të rregullt, apo të jashtzakonshëm të goditjes të vendimeve përfundimtare të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

12. Sipas dispozitave të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, pas vendosjes nga Komisioni për çështje banesore dhe pronësore me vendim i cili është bërë i formës së prerë, çështja e vendosur trajtohet, *res judikata* , **sepse sipas nenit 2.5, të kësaj Rregullore në çështjet e pronave banesore, jurisdiksioni i gjykatave lokale ishte përjashtues, ndërsa komisioni ka kompetenca ekskluzive për të zgjidhë kategoritë e kërkesave të theksuara si në nenin 1.2, të kësaj rregullore.**

13. Ngjajshëm është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sa u përket vendimeve të formës së prerë të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore,(shih

Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin me numër, KI 104/10, e në mënyrë specifike paragrafët, 64-75, të këtij aktgjykimi).

14. Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 13, par. 1 dhe 2, dhe neni 13. 3 c), të Rregullores së UNMIK, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin, nr. 03/L-079, dhe neni 16.3, parag.3.2, të Ligjit 05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike;

15. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktvendim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm, i njëjti nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GJSK-KPA-A- 004/2020, me datë 24 Dhjetor 2020

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani